



1735
19.3.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE

NIPT L71710039A

Nr.2204 Regj
Nr.746 Prot

Tiranë, më 18.03.2024

URDHËR
“PËR HEQJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”

Drejtuar: Qendra Kombetare e Biznesit ✓
Adresa: Tirane
Per dijeni: BERALB sha me Nipt K12107002A
Adresa: Fushe-Arrez, Puke, Shkoder
Per dijeni: Drejtoria Rajonale e Inspektoriatit Shteteror te Punes dhe Sherbimeve Shoqerore Shkoder, Rajoni V
Adresa: Shkoder

Unë, Eris Sotiri, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Zyrës Përmbarimit Privat “REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Vendimi Nr.79 (513), date 15.06.2023 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.2205, Datë 21.02.2024 kërkesën e kreditorit Drejtoria Rajonale e Inspektoriatit Shteteror te Punes dhe Sherbimeve Shoqerore Shkoder, Rajoni V ndaj debitorit “BERALB sha me Nipt K12107002A, në lidhje me titullin ekzekutiv “Vendim Perfundimtar i Inspektimit me Nr.ISHPSHSH-SH-2022-000479-5 date 24.10.2022...”

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr. 461 Prot, Datë 20.02.2024, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Vendimi Nr.79 (513), date 15.06.2023 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile, Me Shkresën Nr.590 Prot, datë 05.03.2024 është dërguar Urdhër për Vendosjen e Sekuestros Konservative mbi aktivet e pales debitore BERALB sha me Nipt K12107002A, me qellim mostjetersimin e tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi qe do te sillte ndryshime ne regjistrin tregetar.

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet proceduriale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

KONSTATOVA:

Se pas verifikimit te llogarive bankare rezulton qe detyrimi, eshte ekzekutuar teresisht.
Në këto kushte, referuar nenit 616 Pika (a) të Kodit të Procedurës Civile dhe të Ligjit Nr. 26/2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”,

URDHËROJ:

1. Heqjen e masës së Sekuestros Konservative, të vendosur me anë të shkresës Nr.590 Prot, datë 05.03.2024, mbi aktivet e pales debitore BERALB sha me Nipt K12107002A, me qellim mostjetersimin e tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi qe do te sillte ndryshime ne regjistrin tregetar.
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

“ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE”
PËRMBARUESI GJYQËSOR
ERIS SOTIRI

